



**BASHKIA KLOS**  
**KËSHILLI BASHKIAK KLOS**

**Njoftim për dëgjese publike**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 18, si dhe në Ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” për garantimin e pjesëmarrjes publike në procesin e vendimmarrjes, dhe në VKM nr.247, datë 30.04.2014 “ Për përcaktimin e rregullave të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

**NJOFTOJMË:**

Këshilli i Bashkisë Klos organizon dëgjese publike për projekt- aktin “Për dhënie mendimi për fillim procedurash për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor të kërkuara nga Subjekti”Liri Topalli”, qëllimi veprimtari turistike Kampingje. Me komunitetin dhe palët e tjera të interesuara në fshatin Kurdari, të Njësisë Administrative Suç , *ditën e Marte datë: 21. 03. 2023 , ora: 12:00.*

**Titulli :** “Për dhënie mendimi për fillim procedurash për dhënie në përdorim nga fondi pyjor i sipërfaqeve të kërkuara nga subjektet private”.

**Propozuesi:** Konsultimi publik u propozua nga Këshilli Bashkiak Klos.

**Sqarime:** Bazuar në kërkesën e ardhur nga subjekti “Liri Topalli-person Fizik”me NUIS M37519902C.Spërfaqja e kërkuar është 0.5ha,në ngastrat nr.17c .Ekonomia pyjore Balgjaj 2,zona kadastrale 3460.Përdorimi i sipërfaqes:Veprimtari turistike kampingje.

**Kalendari i konsultimit:** Mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve të komunitetit do të bëhet përmes komenteve në email të sekretarit të këshillit [etmondemiri1@hotmail.com](mailto:etmondemiri1@hotmail.com) si dhe në adresën postare për 20 ditë rresht dhe gjatë konsultimit.

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilli i Bashkisë, këshilltarë.
- **Nga komuniteti:** Banorët, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias dhe akademisë, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë.

**Format e konsultimit:** Takim publik.

**Data e publikimit:** 0.2. 03. 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

Klos, më . . . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2023

PËR DHËNIE MENDIMI PËR FILLIM PROCEDURASH PER DHËNIE NË PËRDORIM  
NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQEVE TË KËRKUAR NGA SUBJEKTE PRIVATE.

Mbështetur ne "Ligjin 139/2015" për vetqeverisjen vendore "Neni 54" shkonja "K", në zbatim të ligjit nr. 57/2020, "Për Pyjet" në "VKM. Nr. 888, dt.27.12.2022, Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe Nryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo Zgjerimi i tyre, me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit Administrativ të të cilit është sipërfaqia pyjore e cila do ti nënshtrohet procedurave të dhënies, i kërkojmë këshillit të Bashkisë të.

V E N D O S Ë:

1. Miratimin për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor i kërkuar nga subjekti privat.
  - Subjekti "Liri Topalli – Person Fizik" me NUIS. M37519902C. Sipërfaqia e kërkuar është 0.5 ha, në ngastrën nr. 17c.
  - Ekonomia Pyjore Balgjaj 2. Zona Kadastrale 3460. Përdorimi i sipërfaqes: Veprimtari Turistike Kampingje.

KRYETARI

Ilmi Hoxha

